



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1493/6 prot.,

Datë 28.05.2026

V E N D I M
Nr. 722/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.05.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Kej Group” SHPK dhe “Skyline SC” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, me REF-82085-04-15-2026 me objekt: “Blerje materiale për Laboratorin e Restaurimit dhe Testimeve”, me fond limit 7,218,519.4 (shtatë milion e dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e pesëqindë e nëntëmbëdhjetë pikë katër) Lek pa TVSH, zhvilluar në datën 27.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a

Ankimues: Operatori ekonomik “ISOMETRIC” SHPK me Nipt L92207009A dhe adresë:, Rruga “Dibrës”, Kompleksi Arlis Farmacia, 10 shk.2 App. 2, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a
Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “Skyline SC” SHPK me Nipt M51624039U dhe adresë: Bulevardi Shqiperia e Re, Pallatet Agimi, Shkalla 25, Ap. 399/2, Kati 4, Tiranë

Operatori ekonomik “KEJ Group” SHPK me Nipt. M41707006H dhe adresë: Rruga “Sami Frasheri”, Pallatet “Agimi”, Shkalla 22, Ap. 370, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16.04.2026, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, me REF-82085-04-15-2026 me objekt: “Blerje materiale për Laboratorin e Restaurimit dhe Testimeve”, me fond limit 7,218,519.4 (shtatë milion e dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e pesëqindë e nëntëmbëdhjetë pikë katër) Lek pa TVSH, zhvilluar në datën 27.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

II.2. Në datën 27.04.2026 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 30.04.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “KEJ Group“ SHPK	6,478,210 lekë kualifikuar
2. “O F F I C E CENTER” SHPK	5,100,000 lekë s’kualifikuar
3. “Skyline SC” SHPK	6,822,410 lekë kualifikuar
4. “ISOMETRIC” SHPK	6,908,470 lekë kualifikuar

II.4. Në datën 11.05.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6654 datë 14.05.2026 dhe me nr.1493 prot., datë 14.05.2026 e operatorit ekonomik “ISOMETRIC” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertave së operatorëve ekonomikë “Kej Group” SHPK dhe “Skyline SC” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar me pretendimin si më poshtë:

“.....1. Referuar natyres dhe tipologjise se produkteve te kerkuara ne objektin e kesaj procedura citojme se kemi te bejme me materiale unike dhe me specificitet te larte lidhur me natyren/gjendjen/tempistiken dhe funksionalitetin e reagenteve dhe materialeve te cilat jane kerkuar dhe do te aplikohen ne objektet per arkivim,konservim dhe restaurim gje e cila kerkon pasterti,gjendje dhe rezistence te reagenteve lidhur me restaurimi dhe kryesisht konservimin e objekteve te cilat jane pjese e laboratorit qendror te arkivave. Permbajtja e ketyre reagenteve nuk konsiston veten ne pastertine “Purity” e reagenteve por qendron ne kombinimin autentik te principeve aktive dhe shpesh dhe nga prodhuesit diferencohen dhe cileson si Conservation/Preservation Reagents.

Sa I takon klarifikimit te mesiperme gjykojne te bindur referuar njohurise teknike qe operatoret ekonomik : KEJ Group dhe Skyline SC nuk kane arritur te plotesojne specifikimet sic jane kerkuar ne DST ne funksion te ketij synimi laboratorik. Kryesisht theksojme se per artikujt e

tabeles se meposhtme nuk jane paraqitur kataloget e duhur teknike dhe nuk eshte arritur te permbushet kriteri.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë skedë teknike ose katalog teknik ose skedë sigurie ose dokumentacion teknik ekuivalent nga prodhuesi/distributori për artikujt me numër rendor nga nr.1, nr.2, nr.4 e deri në nr.24. Për artikujt me numër rendor nr.3, nr.25 e deri në nr. 105 duhet të paraqitet skedë teknike ose katalog teknik ose dokumentacion teknik ekuivalent nga prodhuesi/distributori. Në dokumentacionin si më sipër kërkuar, duhet të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të artikujve të ofruar, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet standarde të tenderit, të përcaktuara në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike”.

Operatoret ekonomik KEJ Group dhe Skyline SC, nuk kane paraqitur katalog ose skede teknike per artikujt e meposhtme ne perputhje me specifikimet teknike duke mos plotesuar specifikimet teknike analitikesht sic jane kerkuar dhe duke mos plotesuar qellimin funksion te artikujve objekt prokurimi, specifikisht per artikujt me numer rendor 4;5;7;11;12;13;14;15;17;21;22;23;24;31;32;33;4;36;37;40;41;55;56;57;73;74;75;76;77;78;79;80;81;89;91;92;95 dhe 96.

Referuar artikujve te mesiperme, gjykojme se OE KEJ Group dhe Skyline SC nuk arrijne te provojne plotesimin e specifikimeve te artikujve te mesiperme nepermjet katalogeve apo skedave teknike gje qe e ben te pamundur kryerjne me sukses te procedures ne fjale. Ndaj mbeshtetur ne kapacitetin teknik te kesaj procedure kerkojme skualifikimin e OE KEJ Group dhe Skyline SC.....”

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-et; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 1493/1 prot., datë 15.05.2026, me kriteret për të cilat operatori ekonomik “Isometric” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “KEJ Group” SHPK dhe operatori ekonomik “Skyline SC” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

II.7. Me shkresën nr.1832/6, datë 22.05.2026, protokolluar me tonën nr. 1493/2 prot., datë 25.05.2026, të ardhur nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik është depozituar nga autoriteti kontraktor vendimi i KSHA-së mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur mos pranimin e saj.

I njëjti vendim është është paraqitur nëpërmjet shërbimit postar me shkresën nr.1832/7 prot., datë 22.05.2026 me objekt “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “ISOMETRIC” SHPK lidhur me vlerësimin në procedurën e prokurimit me nr REF-82085-04-15-2026 me objekt “Blerje materiale për Laboratorin e Restaurimit dhe Testimeve protokolluar me tonën nr. 1493/3 prot., datë 22.05.2026. Bashkëlidhur kësaj shkrese krahas vendimit të KSHA-së janë bashkëlidhur dokumentacioni i operatorit ekonomik “KEJ Group” SHPK si operator ekonomik i renditur i pari në këtë procedurë prokurimi.

II.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të tjera të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “ISOMETRIC” SHPK, për skualifikimin e operatorëve ekonomikë “KEJ Group” SHPK dhe “Skyline SC” SHPK, me pretendimin se katalogu/et ose fragmente të katalogut/eve nuk vërtetojnë se plotesojnë specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në ankesën drejtuar pranë autoritetit kontraktor dhe pranë KPP, operatori ekonomik ankimues nuk parashtron fakte të bazuara, se cilat nga specifikime teknike nuk plotësohen nga këta operatorë ekonomikë për artikujt që ai citon në ankesën e tij, por ngre pretendime a-priori, lidhur me mos plotësimin e specifikimeve teknike për artikujt me numer rendor 4;5;7;11;12;13;14;15;17;21;22;23;24;31;32;33;4;36;37;40;41;55;56;57;73;74;75;76;77;78;79 ;80;81;89;91;92;95 dhe 96.

III.1.2. Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (*krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitit të ankimuesit dhe respektimit të afateve*) edhe “*elementet e domosdoshme të ankesës*” sipas përcaktimeve të nenit 48, “*Kushtet formale të ankesës*”, pika 3:

- *Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni*

III.1.3. Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicie dhe argumente ose dokumentacionin përkatës se cilin nga specifikimet për këta artikuj nuk plotësohen sipas atyre të përcaktuar në DST në bazë të të cilave do të shqyrtohej kjo ankesë. Vlen të ritheksojmë se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 90 të LPP dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

III.1.4. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kritereve apo specifikimeve teknike nga ana e operatorëve të tjerë ekonomikë. Theksojmë se mospërmbushja e kriterit apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kriteresh.

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik thekson dallimin e qartë – në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikusht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe, pretendimit/premendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesëmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër.

III.1.6. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe, në kuptim të misionit të tij për të siguruar eficientë e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim pro aktiv, në krah të operatorit ankimes. Në rastin e dytë, kur operatori pjesëmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion *re-aktiv*, në pritje të argumenteve të plotë provues se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimesit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është në drejtë të operatorëve ekonomikë të paraqesin pretendime mbi kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës së operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke justifikuar kështu interesin e tyre të ligjshëm, por ndërkohë, operatorët ekonomikë nuk mund të parashtrojnë pretendime a-priori duke mos identifikuar asnjë element konkret brenda kritereve të veçanta të kualifikimit, si edhe duke mos dhënë asnjë provë apo argument se ku mbështet pretendimet e tij. Vetë Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar në nenin 82 pika 1 të tij se “Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj Një ndër parimet kryesore të së drejtës është ai se “*onus probandi incumbit actori*” se barra e provës bie mbi ankuesin. Gjithashtu, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar të gjitha elementet procedurale, përmes të cilave garantohet e drejta e informimit të operatorëve ekonomikë në kuadër të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik.

III.1.7. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementeve përbërëse të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar përpara tij ose të barabartë me të në ofertë ekonomike, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cenon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

III.1.8. KPP është paraparë nga ligji si një quasi gjykatë. Si e tillë në vendimmarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin, se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme.

Për sa referuar më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme, ndaj pretendimet e operatorit ekonomik “ISOMETRIC” SHPK, për mos përmbushjen nga operatorët ekonomikë “KEJ Group” SHPK dhe “Skyline SC” SHPK të specifikimeve teknike për artikujt (cituat më sipër) nuk do të merren në shqyrtim nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “ISOMETRIC” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, me REF-82085-04-15-2026 me objekt: “Blerje materiale për Laboratorin e Restaurimit dhe Testimeve”, me fond limit 7,218,519.4 (shtatë milion e dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e pesëqindë e

nëntëmbëdhjetë pikë katër) Lek pa TVSH, zhvilluar në datën 27.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

2. Autoriteti kontraktor, të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatorit ekonomik “ISOMETRIC” SHPK
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

